

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“AXHA GROUP” SHPK**

Në Tiranë, sot, më datë 01.10.2021, ortakët si më poshtë:

1. **Z. Andi Bano**, i biri i Petrit, shtetas shqiptar, lindur më 28.03.1988 në Berat dhe banues në adresën: Rr. “Sali Butka”, Pallatet “Dobi”, Hyrja 1, Kati 6, Ap. 18, identifikuar me Letërnjoftim me nr. Personal I80328086Q, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
2. **Z. Xhejms Karbunara**, i biri i Vasillaq, shtetas shqiptar, lindur më 11.06.1988 në Tiranë dhe banues në adresën:Rr. “Tish Dahija”, Pallatet “Hawai” Kulla 3, Shkalla 1, Ap. 11, Tiranë, identifikuar me Letërnjoftim me nr. Personal I80611088C, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;
3. **Z. Albert Halilaj**, i biri i Shkëlqim, shtetas shqiptar, lindur më 15.11.1986 në Tiranë dhe banues në adresën:Rruga e Zallit, Nr. 42, Selitë, Tiranë, identifikuar me Letërnjoftim me nr. Personal I61115049K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Vendosën të hartojnë këtë Akt Themelimi, me përmbajtje si më poshtë:

**NENI 1**  
**DATA E THEMELIMIT**

Sot, më datë 01.10.2021, themeluesit Andi Bano, Xhejms Karbunara dhe Albert Halilaj vendosën të krijojnë një shoqëri me emërtimin “AXHA GROUP” SHPK.

**NENI 2**  
**FORMA E SHOQËRISË**

Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

**NENI 3**  
**EMËRTIMI**

Emri i plotë i shoqërisë është “AXHA GROUP” SHPK.

**NENI 4**  
**SELIA**



Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati "Nord Konstruksion", Kati 5, Ap. 46.

Me miratim të organeve të saj, shoqëria mund të ndryshojë selinë. Mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

## NENI 5 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë, ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## NENI 6 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria "AXHA GROUP" SHPK do të ketë si objekt të veprimtarisë:

Të ushtrojë aktivitetin në fushën e hoteleri turizmit, bar-restorant, SPA, komplekse e palestra sportive, projektim dhe zbatim të punimeve të ndërtimit si dhe cdo veprimtari tjetër tregtare që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar.

## NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10 000 (dhjetë mijë) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortakët si më poshtë:

Emri	Përqindja %	Kuota (pjesë)	Vlera e pjesëmarrjes
Andi Bano	33.4 %	1 (një)	3.340 (tremijë e treqind e dyzetë)
Xhejms Karbunara	33.3%	1(një)	3.330 (tremijë e treqind e tridhjetë)
Albert Halilaj	33.3 %	1(një)	3.330 (tremijë e treqind e tridhjetë)

Ky kapital është i ndarë në 3 (tre) kuota të zotëruara nga tre ortakët.

Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.



**NENI 8  
ADMINISTRATORI**

**Administratori i parë i shoqërisë "AXHA GROUP" shpk do të jetë:**

**Z. Andi Bano**, i biri i Petrit, shtetas shqiptar, lindur më 28.03.1988 në Berat dhe banues në adresën: Rr. "Sali Butka", Pallatet "Dobi", Hyrja 1, Kati 6, Ap. 18, identifikuar me Letërnjoftim me nr. Personal I80328086Q, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

**NENI 9  
DISPOZITA E FUNDIT**

Ky akt themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore. Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur.

Autorizohet Administratori Andi Bano ose cdo përfaqësues i posaçëm i caktuar prej saj për të kryer veprimet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**THEMELUESIT**

**Andi Bano**

**Xhejms Karbunara**

**Albert Halilaj**

Andi Bano  
Xhejms Karbunara  
Albert Halilaj

